



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Metropolis Geo shpk" të datës 07.09.2025 si dhe sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Metropolis Geo shpk" të datës 08.09.2025, që të dy kërkesat e parashtruara kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parqeve dhe hapësirave të tjera publike kreative" me nr. të prokurimit 616-25-7034-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHEN** si të pasafatshme kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Metropolis Geo shpk" të datës 07.09.2025 si dhe kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Metropolis Geo shpk" të datës 08.09.2025, që të dy kërkesat e parashtruara kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parqeve dhe hapësirave të tjera publike kreative" me nr. të prokurimit 616-25-7034-5-1-1.
- II. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Metropolis Geo shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 07.09.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parqeve dhe hapësirave të tjera publike kreative" me nr. të prokurimit 616-25-7034-5-1-1. Për aktivitetin e njëjtë dhe me pretendimet e njëjta ankimore, parashtruesi ka dorëzuar një kërkesë për rishqyrtim edhe me datë 08.09.2025.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se të dy kërkesat për rishqyrtim janë parashtruar pas afatit. Përmes nenit 60 par. 1 nënpar. a) është përcaktuar se "Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0)". Në rastin konkret sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, hapja e ofertave është paracaktuar me datë 12.09.2025. Kjo nënkupton që data 12.09.2025 është dita zero (0) ndërsa data e fundit kur kanë

mundur të parashtrohen kërkesa për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit ka qenë data 05.09.2025 deri në ora 16:00.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesat për rishqyrtim janë paraqitur pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 paragrafin a) të RRPP dhe si e tillë ajo duhet të refuzohet si palejuar përkatësisht si e pasafatshme në kuptim të nenit 62.1. paragrafit a) lidhur me nenin 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) të RRPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin b) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1. nënparagrafin a) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.09.2025

Visar SHEHU


Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.